

## REKOMANDIM PËR PROAKTIVITET

Shpenzimi i parasë publike imponon detyrimin për funksionim transparent të institucioneve dhe justifikimin e fondeve të shpenzuara. Rregulli i përgjithshëm zbatohet për administrimin efikas dhe transparent: vlera për fondet publike. Shërbimet e administratës publike kanë vlerë nëse ofrohen në kohë, në mënyrë efikase, në mënyrë që të jenë të dukshme, të qarta dhe lehtësisht të aksesueshme për të gjithë përdoruesit. Qëllimi i publikimit proaktiv të informacioneve me karakter publik është krijimi i një administrate publike efikase, efektive dhe transparente në përputhje me parimet e Zonës Administrative Evropiane dhe elementet bazë të qeverisjes së mirë. Proaktiviteti në mënyrë indirekte tregon nevojën për të rritur nivelin e transparencës midis poseduesve të informacioneve me karakter publik.

Një vlerë e veçantë e transparencës së administratës publike qëndron në integritetin e saj. Vetëm administrata publike transparente forcon besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore në atë masë që vetëm qeveria transparente përfaqëson autoritetin legjitim. Transparenca e administratës është thelbësore, përkatësisht:

- justifikon ekzistencën e aparatit administrativ;
- forcon besimin e qytetarëve tek përfaqësuesit e qeverisë të zgjedhur në mënyrë legjitime;
- kursen burimet;
- inkurajon krijimin e një shoqërie të dijes dhe kompetencës dhe
- institucione të hapura dhe një shoqëri më demokratike

Një nga mënyrat për të arritur transparencën e administratës publike është publikimi proaktiv i informacionit dhe komunikimi i institucioneve në faqet e tyre zyrtare të internetit.